



## MBAHET KONFERENCA E PARË NDËRQEVERITARE SHQIPËRI-BE

U mbajt në Bruksel Konferenca e parë Ndërqeveritare Shqipëri-BE, e cila i hap rrugën Shqipërisë për anëtarësimin në BE. Në takimin për shqyrtimin analitik të legjislacionit Shqipëri, Maqedoni e Veriut, BE, MEPJ Xhaçka, u shpreh se anëtarësimi në BE është një nga objektivat strategjikë për të cilin Shqipëria ka punuar shumë ndër vite dhe se hapja formale e negociatave rikthen besueshmërinë në procesin e integritit.



## KREMTOHET 100-VJETORI I VENDOSJES SË MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE MES SHQIPËRISË DHE SHBA

MEPJ dhe Ambasada Amerikane në Shqipëri oganizuan një aktivitet kremtues kushtuar 100-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes Shqipërisë dhe ShBA-ve. Ministria Xhaçka shprehu mirënjohje për gjithçka ShBA ka bërë për Shqipërinë ndër vite, për bashkëpunimin në Këshillin e Sigurimit të OKB-së dhe së fundmi për mbështetjen në procesin e anëtarësimit në BE.



## ARRIHET MARRËVESHJA PËR PENSIONET E SHQIPTARËVE NË ITALI

Shqipëria dhe Italia kanë përfunduar negociimin teknik të marrëveshjes për pensionet. Pas përfundimit të procesit teknik do të ndiqen procedurat për firmosjen e kësaj marrëveshje, nga e cila pritet të përfitojnë rreth 500 mijë shqiptarë.



## MINISTRJA XHAÇKA PRET MINISTRIN E JASHTËM TË PORTUGALISË, JOÃO GOMES CRAVINHO

Ministrja Xhaçka vlerësoi mbështetjen e Portugalisë në rrugëtimin evropian të Shqipërisë, si dhe vizionin realist që ajo ka ndaj Ballkanit Perëndimor. Të dy kryediplomatët vlerësuan rëndësinë e dialogut dhe bashkëpunimit rajonal në kuadër të nismave rajonale.



## NISI SHËRBIMI PËR PAJISJE ME PASAPORTË DHE KARTË IDENTITETI PËR SHQIPTARËT NË KANADA

Nisi shërbimi për pajisje me pasaportë dhe kartë identiteti për qytetarët shqiptarë rezidentë në Kanada. Qytetarët që jetojnë në Kanada, nuk do kenë më nevojë që të udhëtojnë drejt vendeve të tjera për të marrë këto shërbime.



## MINISTRJA XHAÇKA TAKON MINISTRAT THOMAS BYRNE DHE TYTTI TUPPURAINEN

MEPJ Olta Xhaçka, priti në një takim në Tiranë Ministrin e Shtetit për Çështjet Evropiane të Irlandës, Thomas Byrne dhe Ministrin e Shtetit për Çështjet Evropiane dhe Pronësinë të Finlandës, Tytti Tuppurainen. MEPJ Olta Xhaçka i falenderoi për mbështetjen e palëkundur që të dy vendet i kanë dhënë dhe vazhdojnë t'i japin Shqipërisë dhe në rrugën e saj drejt integritit në BE.